# Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

University "Ukshin Hoti" Prizren

## KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com



Universiteti i Prizrenit
University of Prizren
Univerzitet Prizrena
"UKSHIN HOTI"
Pranuar më: 05.09.2022
Zyra e pranimit: 308
Nr. i protokolit: 01-391


**Kryesues i Këshillit Drejtues**
**Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja**

**Prizren, më 05.09.2022**

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 5 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, duke u bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Rregullores për zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, me nr. Prot. 01-380, të datës 01.09.2022, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2022, mori këtë:

## VENDIM

1. Formohet Komisioni Qendror Zgjedhor për organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, në përbërje si në vijim:

   1.1. Prof. Asoc. Dr. Halim Bajraktari – Kryesues;
   1.2. Prof. Ass. Dr. Vilson De Marku – Zëvendës kryesues;
   1.3. Nexhmedin Krasniqi – Sekretar i KQZ-së.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit të sipërshënuar janë të përcaktuara me Ligjin nr. 04/L-037 për Arsim të Lartë në Republikën e Kosovës dhe Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti", Rregulloren për zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, me nr. Prot. 01-380, të datës 01.09.2022, si dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.

3. Përgjegjësitë e KQZ-së janë:
   3.1. përcaktimi dhe zbatimi i dinamikës së zgjedhjeve;
   3.2. përgatitja e listave për zgjedhje;
   3.3. nxjerrja e vendimeve rreth kundërshtimeve kundër listës së zgjedhjeve;
   3.4. çertifikimi i kandidaturave në zgjedhje;
   3.5. konstatimi i numrit të përgjithshëm të mandateve;
   3.6. vlerësimi i listës së kandidatëve;
   3.7. kryesimi i procedurave zgjedhore;
   3.8. identifikimi i listave përfundimtare të atyre që kanë të drejtë vote;
   3.9. konstatimii rezultateve të zgjedhjeve;
   3.10. shpallja e rezultateve të zgjedhjeve;
   3.11. çertifikimi i mandateve;
   3.12. zëvendësimi i mandatit;
   3.13. koordinimi i komisioneve zgjedhore të Fakulteteve për konstituimin e Këshillave të Fakulteteve.

4. KQZ-së i lejohet që t'i angazhoj deri dy anëtar të personelit të Universitetit si asistues për çështje administrative gjatë periudhës zgjedhore.

5. Për të gjitha rastet kur mandati në organet e Universitetit, për personat e zgjedhur sipas kësaj rregulloreje përfundon para kohe, përbërja e njëjtë e KQZ-së dhe KZF-së, janë kompetente për zbatimin e procedurave përkitazi me zëvendësimin e mandatit respektiv.

6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja**

Kryesues i Këshillit Drejtues

Vendimi t'u dërgohet:
- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Njësive akademike;
- Zyrës së Personelit;
- Zyrës ligjore;
- Të përmendurve;
- Arkivit.